



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-21267/21 datë: 18.08.2021



Npi – 01/231 datë: 24.08.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 24.08.2021 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 24.08.2021 (e martë) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nga ZKF - z.Bujar Ferati; Zyrtari Ligjor z.Lulzim Muharremi; z.Gazmend Ademaj, nga zyra për Informim.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Kërkesë për transfer të mjeteve për bartje nga kategoria e rezervës në projekte kapitale,
2. Propozim-vendim për transfer dhe rialokim të ndarjeve buxhetore të projekteve Kapitale për vitin 2021,
3. Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, nga Zyra Kombëtare e Auditorit (ZKA), Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve,
4. Prezantimi i Draft-Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2022-2024,
5. Rishqyrtimi i Vendimit mbi Statutin e QKMF "Vezir Bajrami" Shtime sipas kërkesës së MPL,

Procesverbali Npi-01/231 i datës 24.08.2021

Me kërkesën e Kryesueses së Kuvendit znj.Medina Brahaj, diskutimi për mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 24.08.2021, anëtarëve të KPF-së u është dërguar në formë elektronike në CD-Disc, dhe në formë të tillë e kanë miratuar.

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 21.09.2021, me shumicën e votave miratoi procesverbalet në formë elektronike (CD-Disc) të datave: 01.03.2021, 26.03.2021, 01.06.2021, 22.06.2021, 09.07.2021 dhe 24.08.2021.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj